
POSTIM ARKIVOR

Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 01-90, datë 08.06.1983, “Për dhënien e kufomave të personave që vdesin në repartet e edukimit, burgjet dhe dhomat e izolimit



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË Sekret
MINISTRIA E PUNËVE TË BRËNDSHME Ekzemplar Nr. 1
DREJTORIA E HETUESISË,POLICISË DHE ZBAT.VEND.PENAL

DEKLASIFIKUAR
Plotësisht me Vendim të KDZH Nr. 10 Datë 19.7.2023
AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SHKURIMIT TË SHTETIT

2043
13683

U D H Ë Z I M
I
MINISTRIT TË PUNËVE TË BRËNDSHME
Nr.0490 datë 06.1983

PËR DHËNIEN E KUFOMAVE TË PERSONAVE QË VDESIN NË REPARTIT E RIEDUKIMIT,BURGJET E NË DHOMAT E IZOLIMIT

Për të rregulluar veprimtarinë e organeve tona në rastet kur vdesin të dënuar,të arrestuar ose të ndaluar dhe për të mënjanuar disa të meta që janë konstatuar në praktikën e deritanishme për plotësimin e kërkesave të shtetasve kur të afërmit e tyre të dënuar,të arrestuar e të ndaluar vdesin në repartet e riedukimit,burgjet e në dhomat e izolimit;

U D H Ë Z O J:

1. Kufomat e personave të dënuar,arrestuar apo të ndaluar që vdesin në repartet e riedukimit,burgjet ose në dhomat e izolimit të degëve të punëve të brëndshme të rretheve t'u jepen familjarëve të tyre, me përjashtim të rasteve që përcaktohen në pikat 2 e 3 të këtij udhëzimi. Familjarë për këtë qëllim të konsiderohen bashkëshortia apo bashkëshorti dhe fëmijët e të vdekurit që kanë mbushur moshën 16 vjeç,prindërit,vëllezërit dhe motrat e tij.

2. Nuk jepet kufoma e të dënuarve në këto raste:

a) Personave të dënuar me vdekje që ekzekutohen pasi Presidiumi i Kuvendit Popullor nuk u ka falur jetën.

b) Të dënuarve për krime kundër shtetit.

c) Të dënuarve që për shkak të rrezikshmërisë shoqërore të madhe të tyre trajtohen në mënyrë të posaçme me urdhër të veçantë të

SEKSIONI

Udhezime

PERIUDHA

1944 - 1983

Ky udhëzim përcaktonte procedurat për dhënien ose mosdhënien e kufomave të personave të dënuar, të arrestuar ose të ndaluar, që vdisnin në repartet e edukimit, burgje dhe dhoma izolimi. Dorëzimi i kufomave lejohej për familjarët e afërt, përfshirë bashkëshortët, prindërit, vëllezërit, motrat dhe fëmijët mbi 16 vjeç, me përjashtim të kategorive të përcaktuara në akt, si personat e ekzekutuar me vdekje, të dënuarit për krime shtetërore, personat me rrezikshmëri të lartë, si dhe personat e vrarë gjatë kryerjes së krimeve ose tentativave për arratisje. Për kufomat e paidentifikuara parashikohej mundësia e kalimit të tyre në shërbim të institucioneve mjekësore. Udhëzimi përcaktonte detyrimin për njoftimin e familjarëve brenda 48 orëve, kur dhënia e kufomës nuk lejohej, si dhe njoftimin e menjëhershëm të hetuesisë dhe prokurorisë nga komandat e burgjeve për çdo rast vdekjeje. Në rastet e dyshimeve për vdekje jo të natyrshme ose aksidente në punë, parashikohej fillimi i menjëhershëm i çështjes penale. Shpenzimet e varrimit përballoheshin nga familjarët kur kufoma tërhiqej prej tyre, ndërsa në rastet e mosdorëzimit, varrimi kryhej nga shteti në vende të posaçme, në bashkëpunim me pushtetin lokal. Për varrimet e tilla mbahej evidencë e vendndodhjes, ndërsa identifikimi në terren bëhej nëpërmjet një tabele me numrin përkatës të regjistrimit.


Seksioni 1

Ky akt administrativ-ligjor rregullon procedurat e trajtimit, dhënies ose administrimit të kufomave të personave të dënuar, të arrestuar apo të ndaluar që vdesin në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe dhomat e izolimit. Sipas rregullave të përcaktuara, kufomat u dorëzohen familjarëve të afërt (bashkëshortëve, prindërve, vëllezërve, motrave dhe fëmijëve mbi 16 vjeç), duke përjashtuar rreptësisht rastet e të dënuarve me vdekje të ekzekutuar, të dënuarve për krime shtetërore, personave me rrezikshmëri të lartë që trajtohen me urdhër të veçantë të Ministrit të Punëve të Brendshme, si dhe subjekteve të vrira në përpjekje e sipër, gjatë kryerjes së krimeve apo gjatë tentativës për arratisje. Për kufomat e paidentifikuara parashikohet mundësia e kalimit të tyre në shërbim të institucioneve mjekësore. Në aspektin procedural, dokumenti detyron njoftimin e familjarëve brenda 48 orëve në rastet e ndalimit të dhënies së trupit, si dhe njoftimin e menjëhershëm të hetuesisë dhe prokurorisë nga komandat e burgjeve për çdo vdekje të ndodhur, duke sanksionuar fillimin e menjëhershëm të çështjes penale nëse dyshohet për vdekje jo natyrale ose aksidente në punë. Së fundmi, ky rregullim përcakton se shpenzimet e varrimit përballohen nga familjarët kur kufoma tërhiqet prej tyre, ndërsa në rastet e ndaluara, varrimi kryhet nga shteti në vende të posaçme të koordinuara me pushtetin lokal, duke mbajtur një evidencë strikte të lokacionit dhe duke identifikuar varrin në terren vetëm përmes një tabele me numrin përkatës të regjistrimit

MEDIA #1

Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 01-90, datë 08.06.1983

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË Sekret
MINISTRIA E PUNËVE TË BRËNDSHME Ekzemplar Nr. 1
DREJTORIA E HETUESISË, POLICISË DHE ZBAT. VENDIM PENAL

DEKLASIFIKUAR
Plotësisht me Vendim të KDZH Nr. 13 Datë 13.7.2023
AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

2043
13683

U D H Ë Z I M
I
MINISTRIT TË PUNËVE TË BRËNDSHME
Nr. 0490 datë 8.6.1983

PËR DHËNIEN E KUFOMAVE TË PERSONAVE QË VDESIN NË REPARTIT E RIEDUKIMIT, BURGJET E NË DHOMAT E IZOLIMIT

Për të rregulluar veprimtarinë e organeve tona në rastet kur vdesin të dënuar, të arrestuar ose të ndaluar dhe për të mënjanuar disa të meta që janë konstatuar në praktikën e deritanishme për plotësimin e kërkesave të shtetasve kur të afërmit e tyre të dënuar, të arrestuar e të ndaluar vdesin në repartet e riedukimit, burgjet e në dhomat e izolimit;

U D H Ë Z O J:

1. Kufomat e personave të dënuar, arrestuar apo të ndaluar që vdesin në repartet e riedukimit, burgjet ose në dhomat e izolimit të dërgohen të punëve të brëndshme të rretheve t'u jepen familjarëve të tyre, me përjashtim të rasteve që përcaktohen në pikat 2 e 3 të këtij udhëzimi.

Familjarë për këtë qëllim të konsiderohen bashkëshortia apo bashkëshorti dhe fëmijët e të vdekurit që kanë mbushur moshën 16 vjeç, prindërit, vëllezërit dhe motrat e tij.

2. Nuk jepet kufoma e të dënuarve në këto raste:


a) Personave të dënuar me vdekje që ekzekutohen pasi Presidiumi i Kuvendit Popullor nuk u ka falur jetën.

b) Të dënuarve për krime kundër shtetit.

c) Të dënuarve që për shkak të rrezikshmërisë shoqërore të madhe të tyre trajtohen në mënyrë të posaçme me urdhër të veçantë të

Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 01-90, datë 08.06.1983

MEDIA FAQE #2



2.

të Ministrit të Punëve të Brëndshme.

3.Nuk jepet kufoma e personit që vritet gjatë kryerjes së një krimi ose pas kryerjes së tij në përpjekje ,rezistencë ose duke u larguar për t'i shpëtuar kapjes nga forcat tona ose nga populli,si në rastet e arratisjes në kufi, bandave/ të armatosura,kriminelë të arratisur grabitjeve,vjedhjeve në objekte me rëndësi ekonomike.

Në këto raste kur kufomat ngelen të paidentifikuara mund t'u jepen edhe institucioneve mjeksore për nevojat e tyre.

4. Në rastet që kufoma nuk jepet,komanda e repartit ose e burgut njofton me telegram familjarët e të dënuarit për vdekjen e tij brënda 48 orëve nga çasti i vdekjes.

5. Kufomat e personave të përcaktuar në germat a,b dhe c të pikës 2 si dhe për pikën 3 u jepen familjarëve të tyre vetëm në rastet kur pas vdekjes,me vendim të gjykatës kompetente të dënuarit deklarohen të pafajshëm.

6. Kufomat e personave të ndaluar e të arrestuar që vdesin në dhomat e izolimit në kohën kur ndaj tyre janë duke u zhvilluar hetime ose kur çështja i është dërguar gjykatës dhe ajo nuk ka dhënë vendimin përfundimtar për deklarimin fajtor dhe dënimin e tij,në çdo rast u jepen familjarëve të tyre.

Në raste të veçanta Ministri i Punëve të Brëndshme mund të urdhërojë mosdhënien e kufomave me urdhër të veçantë.


7. Kur vdesin të dënuarit në repartet e riedukimit e në burgje,komandat e repartave e të burgjeve duhet të njoftojnë menjëherë sektorin e hetuesisë në degën e punëve të brëndshme të rrethit dhe prokurorin e rrethit.

Kur nga organet e hetuesisë konstatohen të dhëna se vdekja ka ardhur nga shkaqe jo të natyrshme,aksidenti në punë,etj,fillohet menjëherë çështja penale dhe kryhen veprimet hetimore të nevojshme.

8. Kur nuk ka të dhëna se vdekja e të dënuarit ka natyrë kriminale,organet e hetuesisë vendosin refuzimin e fillimit të çësh-

Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 01-90, datë 08.06.1983

MEDIA FAQE #3



3.

tjes penale.

9. Pas kryerjes nga hetuesia të veprimeve të nëvojëshme e të domosdoshme me kufomën komanda e repartit të riedukimit ose e burgut kur sipas këtij udhëzimi lejohet dhënia e kufomës,njofton me telegram familjarët e të vdekurit për vdekjen e tij,duke theksuar se"në qoftë se duan ta marrin të vdekurin,të paraqiten brënda 48 orëve".

10. Kur vdesin të ndaluarit,të arrestuarit apo të dënuarit në dhomat e izolimit të DPB të rrethit të veprohet sipas pikës 36 të rregullores Nr.01-1 datë 3.1.1981 "Për sigurimin e të arrestuarve e të ndaluarve në dhomat e izolimit dhe gjatë shoqërimit të tyre në qytet e në vende të tjera".

Në këto raste organi i hetuesisë duhet të fillojë menjëherë çështjen penale dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojëshme hetimore për sqarimin e çështjes.

Ndalohet hetimi i kësaj çështjeje nga hetuesi që ka patur në përpara në hetim personin e dënuar ose të ndaluar të arrestuar që ka vdekur.

Familjarët e të vdekurit në këto raste duhet t'i njoftojë për gjegjësi i sektorit të hetuesisë.


11. Komanda e repartit të riedukimit ose e burgut për vdekjen e të dënuarit si dhe përgjegjësi i sektorit të hetuesisë për vdekjen e të arrestuarit ose të ndaluarit duhet të njoftojnë me shkresë zyrën e gjëndjes civile ku ka rregjistrimin personi që vdes.

Për të dënuarit duhet të njoftohet edhe zyra e gjëndjes gjysqsore pranë Gjykatës së Lartë.Një kopje e vendimit përkatës të përfundimit të hetimit të çështjes ose refuzimit të fillimit të saj duhet të vendoset në fashikullin personal të të dënuarit në repartin e riedukimit ose në Drejtorinë e Zbatimit të Vendimeve Penale.

12. Kur familjarët nuk vijnë të marrin kufomën brënda 48 orëve nga koha që u nisat njoftimi i vdekjes,varrimi bëhet nga organet e vendit të ruajtjes e sigurimit të tyre në varrezat e vendit ku ka ndodhur vdekja,sipas rregullave që ndiqen për varrimin e shtetasve

Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 01-90, datë 08.06.1983

MEDIA FAQE #4



4.

nga ndërmarrja komunale duke shënuar edhe emrin e të vdekurit mbi varr

13. Ç'varrosja e kufomave të personave që i kërkojnë familjarët e tyre për t'i vendosur në varrezat e vendbanimit të tyre, në ato raste kur sipas këtij udhëzimi lejohet t'u jepen familjarëve, me qëllim për të parandaluar rastet e përhapjes së sëmundjeve, të lejohet vetëm pas 5 vjetësh nga data e vdekjes sipas rregullave përkatëse të Ministrisë së Ekonomisë Komunale.

14. Shpenzimet e transportit e të varrimit kur kufoma merret nga familjarët përballohen prej tyre.

Kufomat e personave që nuk lejohet t'u jepen familjarëve varrosen me shpenzimet e shtetit.

15. Personat e vdekur për të cilët nuk lejohet dhënia e kufomës varrosen në vende të caktuara posaçërisht në bashkëpunim me organet e pushtetit dhe mbahet evidencë e rregullt sipas modelit të miratuar dhe skemë(hartë topografike)e posaçme për vendin e varrimit. Në kokën e varrit të vendoset një tabelë në të cilën të shkruhet vetëm numëri i rregjistrimit të tij.


16. Kur i dënuari vdes, sendet e tij personale u dorëzohen pjesetarëve të familjes ose të afërmëve kundrejt dokumenteve që vërtetojnë lidhjen e tyre familjare dhe për dhënien e sendeve të mbahet procesverbal në dy kopje në prani të dy dëshmitarëve. Një kopje e këtij procesverbali u jepet atyre personave ,kurse tjetrën e mban organi që ruante sendet.

Me kalimin e 3 vjetëve nga njoftimi i personave që trashëgojnë të dënuarin që vdes dhe kur ata nuk paraqiten për tërheqjen e tyre, sendet personale kalojnë në pronësi të shtetit sipas dispozitave të Kodit Civil.

17. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe shfuqizon pikat 148, 149 e 150 të rregullores së miratuar me urdhërin e Ministrit të Punëve të Brëndshme Nr.01-33, datë 24.10.1977"Mbi sigurimin dhe rieducimin e të dënuarve në repartet e rieducimit e në burgje" si dhe

Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 01-90, datë 08.06.1983

MEDIA FAQE #5



5.

fjalinë e fundit të pikës 36 të rregullores Nr.01-1 datë 3.1.1981 "Për sigurimin e të arrestuarve e të ndaluarve në dhomat e izolimit dhe gjatë shoqërimit të tyre në qytet e vende të tjera."

18. Me këtë udhëzim të njihen të gjithë kuadrot e organeve dhe reparteve të Ministrisë së Punëve të Brëndshme.

MINISTRI I PUNËVE TË BRËNDSHME

HEKURAN ISAI

Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 01-90, datë 08.06.1983

INFORMACION

Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 01-90, datë 08.06.1983

VITI	1983
NUMËR	01-90
FAQE	5

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.